



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE MITROVICË
OSNOVNI SUD MITROVICI - BASIC COURT OF MITROVICA

P.nr.226/2018

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, Departamenti i përgjithshëm, me Gjyqtarin e vetëm gjykues Bekim Veliqi, procesmbajtëse Mihane Miftari, në çështjen penale ndaj të pandehurit [REDACTED] me vendbanim në Mitrovicë, nën dyshim për veprën penale Rrezikim i trafikut publik neni 378 par.8 lidhur me par.6 e par.1 të KPRK-ës, sipas Propozim akuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë PP.nr.592/2015, të dt.01.09.2015, akuzën e ka përfaqësuar Prokurori i Shtetit pranë Prokurorisë Themelore në Mitrovicë Sahit Tmava, në prezencë të të pandehurit [REDACTED] nga Mitrovica, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit gjyqësore dhe publike në praninë e Prokurorit të Shtetit, të pandehurit, në bazë të nenit 359, 360, 366 të KPP-se, me dt.30.05.2018, morri dhe publikisht shpalli aktgjykimin, ndërsa aktgjykim është përpiluar me dt.05.06.2018;

AKTGJYKIM

I akuzuari;

[REDACTED] nga i ati [REDACTED] e ëma [REDACTED] e vajzërisë [REDACTED] i lindur me dt.17.12.1979 në Mitrovicë, me venbanim në rr. [REDACTED], [REDACTED] me profesion [REDACTED], [REDACTED] Serb, Shtetas i R. Kosovës, i martuar, prini dy fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike.

Gjykata në bazë të nenit 363 par.1 nënpar.1.1 të KPP-ës, pas heqjes dore të Prokurorit të Shteti nga ndjekja penale ndaj të pandehurit merre këtë;

REFUZOHET AKUZA

SEPSE: I pandehuri me dt.31.10.2011 rreth orës 11:30 duke lëvizur me automjetin e tij të markës "Opell Zafira" ngjyre hiri metalike, me numër të regjistrimit KM-004-TW, në rrugën [REDACTED] nga pakujdesia ka rrezikuar trafikun publik, jetën e njerëzve e në kundërshtim me dispozitat e nenit 45 e 30 të LSKRR, shpejtësinë e lëvizjes nuk ia ka përshtatur kushteve dhe rrethanave në rrugë në mënyrë që automjetin ta ndal në mënyrë të sigurt para çdo pengese- i pandehuri ka qene i obliguar të ketë kujdes ndaj këmbësoreve të cilët gjenden në rrugë apo të cilët hyjnë në rrugë dhe të vozis me kujdes të shtuar posaçërisht kur dihet fakti se kjo rrugë është e ngarkuar tere ditën me automjete dhe këmbësorë (aty është Disapanzeri i fëmijëve dhe shkolla e mesme teknike), i pandehuri me automjetin e tij të larte cekur godet këmbësoren – të dëmtuarën [REDACTED] me rrotën e djathë të veturës e cila ishte duke kaluar rrugën nga kjo goditje e dëmtuara pëson lëndime trupore dhe atë : thyerje e kockës së zogut të brendshëm të këmbës së majte, lëndime këto që bëjnë pjese në dëmtime të rënda trupore me pasoja të përkohshme në shëndet.

Me këtë kishte për ta kryer veprën penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 8 e lidhur në par.6 e par.1 të KPRK-ës.

Shpenzimet procedurale në këtë çështje penale bijën në barre të mjeteve buxhetore.

Pala e dëmtuar për realizmin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontestin civilo juridik.

Arsyetim

Prokuroria Themelore në Mitrovicë Departamenti i përgjithshëm pranë Gjykatës Themelore në Mitrovicë, ka parashtruar Propozim akuzën PP.nr.592/2015, dt.01.09.2015, ndaj të pandehurit [redacted] nga Mitrovica, ku edhe jeton ,për shkak të veprës penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 8 e lidhur ne par.6 e par.1 te KPRK-ës.

Gjyqtari i vetëm gjykues ka caktuar seancën e shqyrtimit gjyqësor dt.10.04.2018, dhe sipas udhëzimeve te theksuara sipas Aktvendimit te Gjykatës se Apelit ne Prishtine PA1 nr.803/2017, dt.14.03.2018, gjatë rrjedhjes se seancës gjyqësore është marre aktvendim dhe lënda është dërguar per marrjen e mendimit nga grupi i eksperteve te komunikacionit pranë Universiteti te Prishtinës "Hasan Prishtina" Fakulteti i i Inxhinierisë Mekanike ne Prishtine.

Me dt.15.05.2018, është dhene mendimi nga grupi i eksperteve te komunikacionit, ku nga nje para seancës se shqyrtimit gjyqësor te dt.30.05.2018, i është dorëzuar palve.

Ne seancën gjyqësore te dt.30.05.2018, Prokurori i Shtetit ka deklaruar se pas marrjes se mendimit nga grupi i eksperteve pranë Universiteti te Prishtinës "Hasan Prishtina" Fakulteti i i Inxhinierisë Mekanike ne Prishtine, lidhur me lëshimet e pjesëmarrëseve ne komunikacion, qe eshte konstatuar se aksidenti është shkaktuar nga dalja e befasishme e këmbësorës – të dëmtuare ne rruge, andaj tërhiqem nga nga ndjekja ndaj te pandehurit [redacted]


Pasi qe Prokurori i Shtetit duke u bazuar dhe pasur mbështetje ligjore sipas nenit 52 te KPP-ës, ku përcaktohet se Prokurori Shtetit mund të tërhiqet nga ndjekja penale deri në përfundimin e shqyrtimit gjyqësor para Gjykatës Themelore, po ashtu edhe në mbështetje të Ligjit për Prokurorin e Shtetit Ligji nr.03/L-225, neni 7 ku përcaktohet Detyrat dhe kompetencat e prokuroreve veprim i cili është ndërmarrë nga ana e Prokurorit te Shtetit në seancën e shqyrtimit gjyqësorë e dt.30.05.2018, duke hequr dore nga ndjekja penale ndaj të pandehurit, andaj Gjyqtari e ka shpall të përfunduar shqyrtimin gjyqësor dhe është vazhduar me shpalljen e aktgjykimit, që është bere po të njëjtën ditë në mungesë të Prokurorit të Shtetit, në mungese të pandehurit, në seance të hapur dhe publike.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale, gjykata e mur komfort neneve 454 të KPP-ës, ndërsa udhëzimi i palës se dëmtuar për realizmin e kërkesës pasurore juridike në kontest civil u mbështet ne nenin 463 te KPP-ës.


Nga theksimet e theksuara si me lartë u vendos si ne dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i përgjithshëm
P.nr.226/2018, dt.05.06.2018

Procesmbajtësja
Mihane Miftari



Gjyqtari
Bekim Veliqi



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjete) ditësh prej ditës së pranimiit te këtij aktgjykimi, përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit ne Prishtinë.